



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.970/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Milena Gjeriq e Valon Totaj anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridiko civile të paditësit A. B nga Komuna e Kaçanikut, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për kompensimin e dëmit-humbjes së vlerës së pasurisë së paluajtshme të mbetur jashtë shpronësimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr. 107/17 të datës 10.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 08.02.2022, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr. 107/17 i datës 10.12.2019, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit, miratohet ne tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. B nga Komuna e Kaçanikut dhe detyrohet e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, që paditësit t'ia paguaj në emër të dëmit të pësuar për shkak të humbjes së vlerës së sipërfaqes së pa shpronësuar për pjesën e ngastrës kadastrale 217-0 në sipërfaqe prej 545m<sup>2</sup> Zona Kadastrale Komuna e Kaçanikut, shumën 2,180.00€, me kamatë prej 8% duke filluar nga data 12.11.2019. Në pikën II., të dispozitivit detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën nga pika I e dispozitivit të aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën 750.94€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, ka paraqitur ankesë pala e paditur për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet aktgjykimi i atakuar si i pa bazuar dhe të refuzohet kërkesëpapia e paditësit në tërësi si e pa bazuar.

Pala paditëse ka parashtruar përgjigje në ankesë, me propozim që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i atakuar të mbetet në fuqi.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimi i atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, të LPK, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi A. B ka parashtruar padi ndaj të paditurës Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj vlerën e humbur të sipërfaqes prej 545m<sup>2</sup> së pa shpronësuar e parcelës 217-0 ZK Komuna Kaçanik, shumën 2,180.00€. Të detyrohet e paditura edhe për shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat si: kopja e planit e datës 18.04.2017, ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë e datës 25.07.2019, raporti i vlerësimit nga eksperti Kushtrim Osmani i datës 11.10.2019.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se: paditësit i është shpronësuar pjesa e ngastrës kadastrale 217-0 ZK Komuna e Kaçanikut, ndërsa sa i përket caktimit të kompensimit të pjesës së shpronësuar këtë çështje palët e kanë zgjidhur në procedurë jashtëgjyqësore, kurse me rastin e shpronësimit të kësaj paluajtshmërie me nr.217-0 ZK një pjesë e saj në sipërfaqe prej 545m<sup>2</sup>ka mbetur jashtë shpronësimit dhe kësaj sipërfaqe i ka humbur vlera reale e cila ishte para shpronësimit, me ç' rast paditësit i është shkaktuar dëm me veprimet e të paditurës, vlera e dëmit të pësuar arrin shumën 2,180.00€.

### **Baza ligjore:**

Neni 194 i LPK-së: "Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e

dispozitive të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: .....d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur”.

Neni 319.1 i LPK-së: “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”.

### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:**

Nga gjendja e vërtetuar faktike kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë aktgjykim i cili sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare duke dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për një vendosje të këtillë, bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje kontestimore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjyimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjyimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesës së parashtruar me propozim dhe në lidhshmëri me këtë, ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se në rastin konkret është bërë zbatim i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sa i përket bazës për kompensim, kolegji gjen se, për rastin konkret janë kryer edhe ekspertizat e nevojshme, që e dokumentojnë një gjë të tillë. Nga shkresat e lëndës kolegji gjen se paditësit i është shpronësuar pjesa e ngastrës kadastrale ... Komuna e Kaçanikut, kurse me rastin e shpronësimit të kësaj paluajtshmërie një pjesë e saj prej 545m<sup>2</sup> ka mbetur jashtë shpronësimit dhe kësaj sipërfaqe i ka humbur vlera reale, ku paditësit i është shkaktuar dëm me veprimet e të paditurës. Ndërsa nga ekspertiza e ekspertit vlerësues Kushtrim Osmani është vërtetuar se pjesa e

ngastrës ... ZK Kaçanik ka humbur vlerën sepse kjo sipërfaqe është përgjysmuar si tërësi dhe në të ardhmen ka problem në shfrytëzimin e saj sepse ka mbetur sipërfaqe shumë e vogël, e ngushtë dhe e njëjta nuk mund të shfrytëzohet ashtu siç është shfrytëzuar deri para shpronësimit dhe vlera totale e sipërfaqes së pa shpronësuar është 2,180.00€. Lidhur me ekspertimin e kryer nga eksperti vlerësues, kolegji ekspertizën e kryer lidhur me këtë çështje e ka vlerësuar si të rregullt dhe profesionale, ngase përmban të gjithë parametrat vlerësues dhe përmbush konditat e një ekspertimi të rregullt në një çështje të tillë të vlerësimit.

Kolegji gjenë gjithashtu se, në nenin 322.3 të LPK-së është përcaktuar se: “Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”. Sipas vlerësimit të kolegjit, në rastin konkret e paditura përveç kontestimit verbal, nuk ka ofruar ndonjë provë që do të provonte një gjendje tjetër nga sa është vendosur.

Bazuar në nenin 319.1 të LPK-së, secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Për këto arsye kolegji i gjykatës së shkallës së dytë ka vlerësuar se pala e paditur nuk ka arritur që të bëjë një gjë të tillë, andaj edhe ankesa e parashtruar për këtë çështje, është vlerësuar si e pa themeltë dhe për këtë gjë edhe është refuzuar si e pa bazuar, kurse është vërtetuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.970/20, me datë 08.02.2022

Kryetari i kolegjit - gjykatësi

Dr.sc. Rafet Haxhaj